



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 968/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Ngadhënjim Makolli, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar Apeli Anr.968/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Ngadhënjim Makolli, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Prishtinë të subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Prishtinë, në Vendvotimet: 1911E/09D, 1920E/02R, 1919E/05R, 1911E/09D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimet të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit paraqitur nga Ngadhënjim Makolli, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rinumërimin, për vendvotimet: 1919E/06D, 1919E/02R

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.968/2021 nga Ngadhënjim Makolli, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje

(LVV), dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në të cilën kërkon që të rinumërohen vendvotimet 1911E/09D, 1920E/02R, 1919E/05R, 1911E/09D 1919E/06D, 1919E/02R pasi që pretendon se i mungojnë votat e votuesve të tij. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa votuesve për të cilët pretendon se kanë votuar për të.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të votave të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Ngadhujim Makolli, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Prishtinë, me provat e ofruara nga pala ankuese, deklarata e votuesve dhe rezultate e publikuara të KQZ ka mos përputhje të numrit të votave, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Prishtinë për Vendvotimet: 1911E/09D, 1920E/02R, 1919E/05R, 1911E/09D; dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Apeli në pikën IV të dispozitivit është i pa bazuar për arsye se nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal në Prishtinë Ngadhujim Makolli, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Prishtinë, kërkon rinumërimin e votave për vendvotimet: 1919E/06D,

1919E/02R është i pa bazuar për faktin se për të njëjtin vendvotim, KQZ-ja veç ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruara nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesi nuk ka ofruar prova shkresore që do ta argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si te tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.968/21 më datë 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.